



TË DHËNAT MBI NDËRMARRJEN

Emri i NSH-së	NSHB ELAN (“Ndermarrja”)
Emri i Ndërmarrjes së Re	Ndërmarrja e Re Gllavotin SH.P.K.
Lokacioni	Fshati Gllavotin– Komuna e Vushtrrisë
Biznesi/Spektori	Agrikulturë
Produktet	Ndërmarrja kultivon produkte bujqësore për industrinë e përpunimit të ushqimit. Viteve të fundit ka prodhuar grurë, misër, dhe tërshërë. E mbjella kryesore e saj momentalisht është gruri. Në këtë tokë do të kishte mundësi kultivimi për prodhimin e grurit dhe misrit apo edhe ndërtimi i ndonjë objekti me nevojë.
Tregu	Në Kosovë momentalisht operojnë disa fabrika për përpunimin e ushqimit. Klientët kryesorë të ndërmarrjes viteve të fundit kanë qenë fabrika e birrës në Pejë si dhe disa mullinj të ndryshëm të miellit. Klientët kryesorë momentalisht janë NSh dhe kompanitë e ndryshme private.
Konkurrenca	Një numër i madh i prodhimeve bujqësore janë importuar pas vitit 1999 në Kosovë. Prandaj, ekziston një potencial i madh për zëvendësimin e importit. Konkurrenca përbrenda Kosovës për momentin është e kufizuar por pritet të rritet sa ma shumë që Ndërmarrjet Shoqërore të privatizohen apo të ristrukturohen me qëllim të rritjes së prodhimit.
Punëtorët	Ndërmarrja ka 19 punëtorë të punësuar.
Ndërtesat dhe tokat	Toka e Ndërmarrjes së Re Gllavotin SHPK e regjistruar ne Certifikatën mbi te drejtat e pronës se paluajtshme nr.UL-70202017-00064 përfshinë një sipërfaqe prej 10ha 04ari 92m ² (100,492m ²). Nuk ka objekte të transferuara në Ndërmarrjen e Re. Gjate vizitës sonë në terren parcelat shfrytëzohen nga ana e fshatarëve, pa marrëveshje paraprake me Menaxhmentin e Ndërmarrjes.
Detyrimet që do të barten	Në Ndër. e Re do të barten vetëm disa detyrime të kufizuara, si dhe kontrata me furnizuesit dhe konsumatorët që janë të domosdoshme për veprimet në vazhdim e sipër të Ndër. së Re.

**Foto e
Ndërmarrjes së
Re.**



Informata

Departamenti i Shitjes
Agjencia Kosovare e Privatizimit
Tel: +381 (0) 38 500 400 ext 1255
Fax: +381 (0) 38 500 400
www.pak-ks.org

**Dokumentet e
Ofertimit**

Agjencia Kosovare e Privatizimit
Rruga: Ilir Konushevcu Nr:8
10000 Prishtinë, Kosovë

Asnjë informacion rreth ndërmarrjes i paraqitur në këto të dhëna nuk është i garantuar. Investitorët e mundshëm inkurajohen të kontaktojnë Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) të kërkojnë dokumentet për ofertim. Ata të cilët dëshirojnë të dorëzojnë ofertë duhet të bazohen në hulumtimin e tyre. Investitorët e mundshëm rekomandohen të kryejnë hulumtimin e tyre paraprak para se të dorëzojnë ndonjë ofertë ose propozim për tender. Këto të dhëna për ndërmarrjen janë në dispozicion sipas kushteve të përgjithshme lidhur me dhënien e informatave publikut mbi kandidatët për privatizim dhe mund të mirren nga faqja e AKP-së në internet: <http://www.pak-ks.org>